



PËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.764/8Prot.

Tiranë, më 23. 09. 2024

V E N D I M

Nr. 251, datë 23. 09. 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 107 Regj., datë 17.05.2024, të znj. J. S, kundër Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar Tiranë (ish DPAP), në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar ankesës së depozituar pranë Komisionerit, subjekti ankues parashtron se: *Kam qenë e punësuar në pozicionin "Specialist jurist", pranë ish-Drejtorisë Arsimore Rajonale Vlorë, sot Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë, për periudhën 01.10.2012-16.10.2023. Deri në muajin maj 2019 kam qenë punonjëse me statusin e nëpunësit civil dhe në këtë periudhë institucioni del nga shërbimi civil. Duke filluar nga muaji maj 2019 marrëdhënia e punës rregullohej në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Në muajin tetor 2023 pozicioni i drejtorit të Zyrës Vendore e Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë ngelet vakant. Me Urdhrin nr. 173, datë 10.10.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Arsimit Parauniversitar krahas detyrave të mia funksionale dhe krahas detyrave të tjera shtesë që kryeja për shkak të një strukture totalisht të papërshtatshme të institucionit, më ngarkon edhe detyrat e drejtorit të institucionit. Urdhër të cilin e refuzova me shkresën nr. 2326 prot., datë 11.10.2023 për arsye se ishte në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në fushën e administratës publike, si dhe për shkak të mbingarkesës që*

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

kishte pozicioni im i punës si juriste. Pra që të kryhet zëvendësimi i kompetencave në një institucion të administratës shtetërore duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte: Së pari, zëvendësimi të jetë parashikuar me ligj dhe së dyti, ligji të ketë parashikuar nëpunësin zëvendësues. Legjislacioni në këtë pikë nuk lë vend për interpretim, zëvendësimi i kompetencave të drejtorit të ZVAP mund të bëhet vetëm nga punonjësit e nivelit më të lart drejtues në institucion dhe që konkretisht punonjës të nivelit më të lartë në ZVAP Vlorë-Himarë, që ishin dy përgjegjës të sektorëve. Në kundërshtim me parashikimet e mësipërme ligjore, në datën 10.10.2023, DPAP dërgon në rrugë elektronike pranë ZVAP-it Vlorë-Himarë, Urdhrin nr. 173, datë 10.10.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Arsimit Parauniversitar, me anë të cilit më ngarkon ushtrimin edhe të funksioneve të drejtorit. Zëvendësimi i ngarkohet një punonjësi të kategorisë ekzekutive "Specialist", kur në institucion ka nëpunës të nivelit të ulët drejtues "Shef sektori", të cilit me ligj i takonte zëvendësimi. Për këtë urdhër kam marrë dijeni ditën që e dërgojnë me email, para nxjerrjes së tij, nuk jam kontaktuar nga askush për të më bërë me dije paraprakisht mbi faktin që më ngarkohen edhe funksionet e drejtorit dhe minimalisht të merrnin mendimin tim mbi këtë vendimmarrje, duke qenë se ligjërisht ky zëvendësim nuk i takonte pozicionit tim të punës (specialist jurist). Ndodhur në këto kushte, ku së pari, urdhri ishte në kundërshtim të plotë me Ligjin nr.44/2025 të Kodit të Procedurave Administrative dhe Ligjin nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", së dyti, askush nuk e mori mendimin tim të më sqaronte situatën, të më shpjegonte përse ishte e domosdoshme që këto detyra ti ushtroja unë kur kishte punonjës të nivelit më të lartë (mjaftohen vetëm duke nisur urdhrin me email, a thua se ishte detyrimi im ligjor), së treti, pozicioni im i punës ishte më i ngarkuari me punë nga të gjithë punonjësit e tjerë, detyrohem të refuzoj urdhrin dhe njëkohësisht të jepja dorëheqje nga pozicioni i punës juriste.

Në dorëheqjen time nga vendi i punës, kam parashtruar si shkak strukturën jofunksionale të ZVAP-ve dhe faktin e mos respektimit të kontratës së punës nga ana e punëdhënësit, i cili më ngarkon me një funksion tjetër shtesë, kur gjatë gjithë kohës që kam punuar në atë institucion kam kryer punë shtesë, jashtë detyrave të mia funksionale, si sekretaria dhe arkiva e institucionit etj,... kam punuar jashtë orarit zyrtar dhe pozicioni im i punës ishte pozicioni më i mbingarkuar se të gjithë pozicionet e tjera të punës në atë institucion, për shkak të strukturës jofunksionale të ZVAP-ve.

Me shkresën nr.2345 prot., datë 11.10.2023 kam dhënë dorëheqje nga vendi i punës me arsyetimin e sipërcituar, duke respektuar afatet e njoftimit për punëmarrësin.

Me vendimin nr.90, datë 16.10.2023, DPAP ka vendosur lirimin tim nga detyra, vendimmarrje të cilën e ka marrë menjëherë pa respektuar afatet ligjore të përcaktuara nga Kodi i Punës në nenin 143/1.

Disa ditë pasi del vendimi i liritimit, në rrugë jozyrtare, mora dijeni se Ministria e Arsimit dhe Sportit po rishikonte strukturat e Zyrave Vendore Arsimore Parauniversitare (Vërtetuar kjo dhe me shkresën nr.595/3 prot., datë 06.03.2024) dhe menjëherë i drejtohem me kërkesën e datës 23.10.2023, Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar duke i shprehur interesin për të vijuar marrëdhënien e punës.

Me shkresën nr.2901/I prot., datë 08.11.2023, DPAP me justifikimin se të gjitha pozicionet e punës të lira do të shpallen për konkurrim, nuk pranon kërkesën time për punësim. Ndërkohë në të njëjtën kohë që unë paraqita kërkesën për punësim me kontratë provizore, deri sa të kryhen procedurat e konkurrit, DPAP punëson pranë Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier, punonjëse me kontratë provizore deri në përfundim të procedurave të konkurrit për pozicionin "Jurist". Pra në një tjetër pozicion nuk pret për procedura konkurrimi dhe punëson punonjës, ndërkohë mua nuk më pranon kërkesën për punësim me justifikimin e konkurrit.

Pasi kalojnë katër muaj nga lirimi im nga detyra dhe vendet e lira për konkurrim nuk u shpallën asnjëherë, përsëris kërkesën time për punësim të përkohshëm, deri në shpalljen e procedurave të konkurrit, për pozicionin "Specialist jurist", pranë ZVAP-it Vlorë-Himarë.

Me shkresën nr.595/I prot., datë 19.02.2014, sërish më refuzojnë kërkesën me arsyetimin se do të shpallen procedurat e konkurrit. Ndërkohë vetëm disa ditë pasi refuzojnë kërkesën time, në datën 27.02.2024, punësojnë në vendin e punës për të cilin unë kam paraqitur kërkesën për punësim ("Specialist jurist" pranë ZVAP Vlorë-Himarë), pa procedurë konkurrimi, një punonjës që nuk ka eksperiencë pune në administratë. Ky fakt vërtetohet me shkresën nr.860 prot., datë 09.05.2024 të ZVAP Vlorë-Himarë. Më diskriminojnë për herë të dytë. Unë ndodhesha në të njëjtat kushte si dy aplikantët të cilat u punësuan nga DPAP, por ndërkohë që kërkesa ime u refuzua me justifikimin e shpalljes së procedurave të konkurrit, kërkesa e dy aplikantëve të tjera u pranua, pa asnjë procedurë konkurrimi, duke iu lidhur kontratën e punës.

Masat që kërkohen të merren nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është konstatimi i diskriminimit në të drejtën e punësimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën nr.107, datë 71.05.2024 bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*"², të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Në nenin 1, të LMD përcaktohet se: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Në nenin 12/1/c, të LMD përcaktohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri ka ndërmarrë hapat si më poshtë:

Me shkresën me nr.764/2 prot., datë 05.06.2024, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Agjencia Kombëtare të Arsimit Parauniversitar Tiranë (ish DPAP), në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, me anë të cilës ka kërkuar si më poshtë:

- Parashtrimet, lidhur me pretendimet e ankueses znj. S.
- Kopje të dosjes personale të ankueses.
- Informacion lidhur me qëndrimin e DPAP Tiranë mbi kërkesat e ankueses për punësim si me kontratë provizore dhe me kontratë të përhershme.
- Informacion nëse ka patur masa disiplinore ndaj znj. S. Nëse po, një kopje të akteve mbi procedurën e ndjekur nga ana e juaj lidhur me dhënien e masave të marra.
- Informacion mbi emërimin me kontratë provizore të punonjësës në DPAP Fier për periudhën që i referohet ankuesja.
- Informacion mbi emërimin e pozicionit të "Specialist juristit", në DPAP Vlorë. (Dosjen e plotë të procedurës së emërimit si dhe dokumentacionin e dosjes së punonjësit të emëruar)
- Informacion nëse ka patur punësime të reja me kontratë ose me konkurrim në ZVAP e tjera, për periudhën që i referohet ankuesja, ky informacion të shoqërohet me dokumentacionin ligjor përkatës për secilin rast.

- Informacion dhe parashtrime lidhur me faktin, nëse nga ana e DPAP Tiranë është konsideruar mundësia e sistemimit të znj. S, në pozicione të tjera, sipas arsimimit dhe kualifikimeve të saj.
- Çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

2. Me shkresën nr. 764/3 prot., date 26.06.2024, Komisioneri bëri një kërkesë të ripërsëritur për dërgimin e informacionit nga ana e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar Tiranë (*ish DPAP*), e cila rezulton që ka marrë dijeni nëpërmjet shërbimit postar, për të dyja shkresat e dërguara nga Komisioneri.

Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri pasi vlerësoi kërkesën e ankueses, caktoi datën 17.07.2024 ora 10.00 për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe njoftoi palët me shkresën nr.764/4 prot., datë 08.07.2024.

Me email-in e datës 17.07.2024 Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (*Ish Drejtoria e Përgjithshme Parauniversitare Tiranë*), ka kërkuar shtyrjen e seancës dëgjimore, për arsye të angazhimeve të tjera të parashikuara më parë nga institucioni.

Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesëmarrjen e ankueses, e cila mori pjesë personalisht.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftua pala se seanca dëgjimore do të regjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, pala ankuese i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me email me Komisionerin si dhe ju përgjigj pyetjeve të bëra nga drejtuesja e seancës për sqarimin e mëtejshëm të kësaj çështjeje.

Me shkresën nr.1940/3 prot., datë 15.07.2024³ Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (*Ish Drejtoria e Përgjithshme Parauniversitare Tiranë*), ka kthyer përgjigje dhe ka depozituar dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri, ku informon se: *Me Urdhrin Nr. 219, datë 15.05.2019 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Znj. J. S, është emëruar Juriste në Zyrën Vendore Arsimore Parauniversitare Vlorë, deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit për këtë pozicion pune sipas përcaktimeve të urdhrin Nr. 234, datë 19.04.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar".*

Në datë 01.10.2023, Znj. J. S, ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga vendi i punës.

³ Administruar pranë Komisionerit me nr. 864/5 prot., datë 16.07.2024

Me vendim Nr. 90, datë 16.10.2023 "Për lirim nga detyra" të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, është bërë dhe miratimi i kërkesës për dorëheqjen nga detyra dhe lirim nga detyra të Znj. J. S, Jurist në sektorin e Shërbimeve të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, ka sqaruar Znj. S, se pranimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve të Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar, Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit, sipas përcaktimeve të nenit 13, të VKM Nr. 99, datë 27.02.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore" si dhe përcaktimeve të nenit 4, të Urdhrit Nr. 454, datë 13.09.2019 "Për miratimin e rregullores dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirim nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj", të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, ka njoftuar Znj. J. S, se ka dërguar kërkesën në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për shpalljen e procedurave të konkurrimit për të gjitha pozicionet e punës në DPAP/DRAP dhe ZVAP-ve. Me miratimin e planit për shpalljen e procedurave të konkurrimit përcaktimeve të nenit 5, të Urdhrit Nr. 454, datë 13.09.2019 "Për miratimin e rregullores dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirim nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj", të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, DPAP-ja, do të bëjë shpalljet ku të gjithë të interesuarit kanë të drejtën që të aplikojnë dhe të konkurrojnë për pozicionet e lira të punës që do të shpallen, sipas profilit të diplomës që disponojnë. Plani për shpalljen e procedurave të konkurrimit, nuk është miratuar akoma nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për arsye të ndryshmeve që priten në strukturat e institucioneve, pasi DPAP me Vendim Nr. 129, datë 06.03.2024 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr.99, datë 27.02.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar" të Këshillit të Ministrave, është emërtuar Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP)

Në lidhje me pretendimin tuaj se Znj. S, është diskriminuar, sqarojmë se në pikën 2, të nenit 9, të Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, përcaktohet qartë rastet e diskriminimit, ku citohet; 2. Me "diskriminim " kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

Në nenin 1 të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, përcaktohet qartë rastet e diskriminimit, ku citohet; Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Për sa më sipër, në asnjë rast nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar sot Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, nuk ka diskriminuar por përkundrazi e ka vlerësuar, duke i ngarkuar përkohësisht dhe detyrat e Drejtorit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë, detyrë të cilën ju nuk e keni pranuar. Znj. S, ka dhënë dorëheqjen nga vendi i punës si Juriste në ZVAP Vlorë-Himarë, me arsyetimin "për shkak të" strukturës jo të përshtatshme të ZVAP-ve, krahas detyrave të pozicionit tim të punës, gjatë kohës kam kryer punë të cilat nuk janë pjesë e detyrave funksionale që ligji më ngarkon si dhe punë jashtë orarit zyrtar" kurse ndërkohë në komunikimet përmes Jush ngre pretendimin për diskriminim lidhur me punësimin në të njëjtën strukturë.

Në vijim të seancës ana e inspektorit të çështjes me email e datës 26.07.2024 drejtuar Agjencisë Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (*Ish Drejtoria e Përgjithshme Parauniversitare Tiranë*), iu kërkua informacion dhe dokumentacion shtesë, i cili ishte e domosdoshëm për të vijuar me trajtimin e ankesës së znj. S.

Nga ana e Agjencisë Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (*Ish Drejtoria e Përgjithshme Parauniversitare Tiranë*), me shkresën nr.2500 prot., datë 31.07.2024⁴, është kthyer përgjigje në lidhje me informacionin e mësipërm, ku informojnë se: *Në përgjigje të email tuaj të datës 26.07.2024, sqarojmë se: Pranimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve në ZVAP, Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit, sipas përcaktimeve të nenit 13 të VKM nr.99, datë 27.02.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore", si dhe përcaktimeve të nenit 4, të Urdhrit nr.454, datë 13.09.2019 "Për miratimin e rregullores dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirimimin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj" të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar sot Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, ka dërguar shkresë ka dërguar kërkesën në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për shpalljen e procedurave të konkurrimit për të gjitha pozicionet e punës në DPAP/DRAP dhe ZVAP-ve. Me miratimin e planit për shpalljen e procedurave të konkurrimit sipas përcaktimeve të nenit 5, të Urdhrit nr. 454, datë 13.09.2019 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit " Për miratimin e Rregullores*

⁴ Administrua pranë Komisionerit me nr. 1129 port., datë 02.08.2024

për rregullat dhe procedurat e konkurrimit dhe lirimit nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj", DPAP do të bëjë shpalljet ku të gjithë të interesuarit kanë të drejtë të aplikojnë dhe konkurrojnë për pozicionet e lira të punës që do të shpallen, sipas profilit përkatës së diplomës që disponojnë. Plani për shpallen e procedurave të konkurrimit nuk është miratuar akoma nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për arsye të ndryshimeve që priten të strukturave të institucioneve, pasi DPAP me Vendimin nr. 129, datë 06.03.2024 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.99, datë 27.02.2019 " Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore", të Këshillit të Ministrave, është miratuar Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar.

Të gjitha emërimet e kryera në strukturat e varësisë janë me kontratë provizore deri në momentin e ristrukturimit.

Me shkresën nr. 764/6 prot., datë 02.08.2024 pranë Komisionerit është administruar informacion shtesë (dosja personale e saj) nga ana e palës ankuese.

Me email e datës 07.08.2024 nga ana e Agjencisë Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (Ish Drejtoria e Përgjithshme Parauniversitare Tiranë) është dërguar informacion shtesë në lidhje me informacionin e kërkuar nga Komisioneri, ku informojnë se:

Ripunësimi i Znj. J. S, nuk është kryer nga institucioni ynë, pasi Znj. S, është larguar me dorëheqje nga vendi i saj i punës. Në kërkesën për dorëheqjen nga detyra, znj. S, shprehet si më poshtë vijon:

"Për shkak të strukturës jo të përshtatshme të ZVAP-ve, krahas detyrave të pozicionit tim të punës, gjatë kohës kam kryer punë të cilat nuk janë pjesë e detyrave funksionale që ligji më ngarkon si dhe punë jashtë orarit zyrtar".

"Në këto kushte, ku nuk respektohen parashikimet e kontratës së punës nga punëdhënësi, referuar përcaktimeve në nenin 13 pika 1 germa "a", të "Rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurrimit dhe të pranimi dhe lirimit nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj", ju njoftoj që jap dorëheqjen time nga vendi i punës".

Për sa më sipër, Znj S, në momentin që ka qenë e punësuar në pozicionin jurist në ZVAP Vlorë, nuk ka qenë dakord me strukturën, kryerjen e punëve të cilat nuk janë pjesë e detyrave funksionale që ligji e ngarkon si dhe për punë jashtë orarit zyrtar, nuk mund të kërkojë të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ndërkohë që nuk kanë ndryshuar as struktura dhe as kushtet e punës për të cilat ka shprehur mosdakordësi.

Znj. S, është në marrëdhënie pune pranë Zyrës së Shërbimit të Provës Vlorë, prej datës 26.01.2024. Nëpërmjet kërkesës së saj, në të cilën pretendon diskriminimin, sqarojmë se nga ana e institucionit tonë i është dhënë gjithë mundësia për të ecur në karrierë duke e ngarkuar të ushtrojë dhe funksionin e Drejtor i ZVAP Vlorë deri në plotësimin e vakancës. Kërkesa për diskriminim e bërë nga Znj. S, është një kërkesë në keqbesim nga ana e ish punëmarrësit, e cila me dashje kërkon të përfitojë financiarisht dhe të dëmtojë reputacionin e punëdhënësit.

Punësimi i Znj. A. Rr, është bërë vetëm për mbarëvajtjen e punës në këtë institucion dhe është me kontratë provizore deri në momentin e ristrukturimit, i cili mendohet të mbyllet brenda muajit Tetor 2024.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm.

Nga dokumentacioni i administruar në lidhje me këtë ankesë, sipas librezës së punës rezultoi se ankuesja është emëruar në Drejtorinë Arsimore Rajonale Vlorë në datën 23.09.2012 në pozicionin "*Juriste në Sektorin e Shërbimeve DAR Vlorë*" deri në datën 20.05.2019 (*Datë e cila rezulton që është bërë dhe lirimi i saj nga shërbimi civil*).

Në bazë të Urdhrit nr. 219, datë 15.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Arsimit Parauniversitar Tiranë, "*Për emërim të përkohshëm në detyrë*", znj. J. S. është emëruar specialist-jurist, në Sektorin e Shërbimeve, në Zyrën Vendore Arsimore Vlorë-Himarë, deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit për këtë pozicion pune. Marrëdhëniet financiare për këtë pozicion i kanë filluar në datën 20.05.2019.

Në zbatim të urdhrit të mësipërm është lidhur Kontrata Individuale e Punës me Afat të Caktuar me nr.275/1 prot., datë 20.05.2019, kjo kontratë ka si datë fillimi 20.05.2019 dhe kohëzgjatja e saj do të vijojë deri në zhvillimin e procedurave konkurruese për këtë pozicion.

Në bazë të Urdhrit 686, datë 22.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Arsimit Parauniversitar Tiranë, "*Për pagesën e dëmshpërblimit të punonjësit*", është urdhëruar që znj. J. S, të dëmshpërblehet në masën prej 322.080 lekë, në përputhje me vjetërsinë në punë si ish punonjëse e DAR/ZA.

Në bazë të Urdhrit nr.173, datë 10.10.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Arsimit Parauniversitar Tiranë, "*Për ngarkimin e ushtrimit të funksioneve të drejtorit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë*", është urdhëruar: znj. J. S, në detyrën e specialistes juriste, në Zyrën Vendore të arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë, ngarkohet të ushtrojë dhe funksionet e Drejtorit të ZVAP Vlorë-Himarë. Kompetencat sipas këtij urdhri ushtrohen deri në plotësimin e vakancës nga njësia përgjegjëse.

Sipas shkresës nr.2326 prot., datë 11.10.2023 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar Tiranë, znj. J. S, ka njoftuar se nuk pranon ushtrimin e funksioneve të titullarit të ZVAP Vlorë-Himarë, për arsye se: *Institucioni ka punonjës të nivelit të ulët ekzekutiv të cilëve mund t'ju delegohet detyra e titullarit të institucionit si dhe duke qenë edhe anëtare e komisionit të vlerësimit, nuk mund të ushtrojë njëkohësisht në komision, funksionet dhe të kryetarit dhe të*

anëtarit. Ndërkohë që ka ende fëmijë të vlerësuar nga komisioni multidisiplinar, që janë në pritje të mësuesit ndihmës.

Me shkresën nr. 2345 prot., datë 11.10.2023 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar Tiranë, znj. J. S, ka shprehur vullnetin e saj për dhënien e dorëheqjes nga vendi i punës për arsye se: *Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar kanë struktura jo të përshtatshme. Krahës detyrave të pozicionit tim të punës, gjatë punës kam kryer punë të cilat nuk janë pjesë e detyrave funksionale që ligji më ngarkon si dhe kam kryer punë jashtë orarit.*

*Në kushtet kur nuk respektohen parashikimet e kontratës së punës nga punëdhënësi, referuar nenit 13 pika 1, shkronja "a" të Rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurrimit dhe pranimit dhe lirimit nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj, **ju njoftoj dorëheqjen time nga vendi punës.***

Në bazë të Urdhrit nr. 90, datë 16.10.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar Tiranë, është vendosur:

1. Miratimi i kërkesës nr. 2345 prot., datë 11.10.2023, për dorëheqjen nga detyra të znj. J. S. 2. Lirimin nga detyra të znj. J. S, juriste në Sektorin e Shërbimeve të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë. 3. Dorëzimin e detyrës dhe materialeve objekt inventari do të kryhen sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. 4. Marrëdhëniet e punës dhe marrëdhëniet financiare të përfundojnë nga data e mosparaqitjes në detyrë.

Ndërkohë rezulton se pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, znj. J. S, i është drejtuar në datën 23.10.2023 me kërkesë Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar Tiranë, ku ka kërkuar të vijojë përsëri marrëdhëniet e punës në pozicionin e juristit.

Me shkresën nr.2901/1 prot., datë 08.11.2024 nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar Tiranë, i është kthyer përgjigje si më poshtë vijon: *Pranimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve në ZVAP, Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit, sipas përcaktimeve të nenit 13 të VKM nr.99, datë 27.02.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore", si dhe përcaktimeve të nenit 4, të Urdhrit nr.454, datë 13.09.2019 "Për miratimin e rregullores dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirimin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj" të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë.*

Së shpejti do të fillojnë konkurrimet për pozicionet e punës, pasi Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka dërguar kërkesën në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për shpalljen e procedurave të konkurrimit për të gjitha pozicionet e punës në DPAP/DRAP dhe ZVAP-ve. Të gjithë të interesuarit kanë të drejtë të aplikojnë dhe të konkurrojnë për pozicionet e lira të punës që do të shpallen, sipas profilit të diplomës që disponojnë.

Kërkesa për punësim është përsëritur nga ankuesja dhe në datën 08.02.2024, dhe nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar është kthyer përgjigje me shkresën nr. 595/1 prot., datë 19.02.2024, ku informon se: *Me shkresën nr.2901/1 prot., datë 08.11.2024 nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar Tiranë, ju është kthyer përgjigje ku ju ka sqaruar se pranimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve në ZVAP, Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit.....Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka dërguar kërkesën në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për shpalljen e procedurave të konkurrimit për të gjitha pozicionet e punës në DPAP/DRAP dhe ZVAP-ve. Me miratimin e planit për shpalljen e procedurave të konkurrimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, DPAP-ja do të bëjë shpalljet ku të gjithë të interesuarit kanë të drejtë të aplikojnë dhe të konkurrojnë për pozicionet e lira të punës që do të shpallen, sipas profilit të diplomës që disponojnë.*

Në lidhje me pretendimin se jeni diskriminuar, sqarojmë se në pikën 2 të nenit 9 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, përcaktohen qartë rastet e diskriminimit, ku citohet: Me "diskriminim" kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

Për sa më sipër, në asnjë rast nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme nuk jeni diskriminuar por përkundrazi ju jeni vlerësuar, duke ju ngarkuar përkohësisht dhe Detyrat e Drejtorit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë, detyrë të cilën nuk e keni pranuar. Ju gjithashtu keni dhënë dorëheqje dhe nga vendi i punës si juriste në ZVAP Vlorë-Himarë, me arsyetimin se Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar kanë struktura jo të përshtatshme. Krahas detyrave të pozicionit tim të punës, gjatë punës kam kryer punë të cilat nuk janë pjesë e detyrave funksionale që ligji më ngarkon si dhe kam kryer punë jashtë orarit, kurse tani pretendoni se jeni diskriminuar për punësim kur ekziston e njëjta strukturë, profil punë, ku ju jeni larguar me dorëheqje.

Në datën 12.03.2024, znj. S, i është drejtuar me një kërkesë ZVAP Vlorë-Himarë, ku kërkon të informohet se në cilën periudhë pozicioni i "specialist jurist", pranë këtij institucion ka qenë i lirë. Me shkresën nr.860 prot., datë 09.05.2024 nga ana e ZVAP Vlorë-Himarë është kthyer përgjigje duke informuar ankuesen se: *Pozicioni i punës "specialist jurist", pranë ZVAP Vlorë-Himarë ka qenë vakant për periudhën 16.10.2023-26.02.2024. Aktualisht vakanca është plotësuar në datën 27.02.2024, vakanca është plotësuar provizorisht deri në procedurat e konkurrimit.*

Ndërkohë dhe në datën 18.03.2014 ankuesja i është drejtuar dhe ZVAP Fier, ku kërkon të informohet se në çfarë periudhe pozicioni i "*specialist jurist*", pranë këtij institucion ka qenë i lirë. Ky pozicion a vazhdon të jetë i lirë? Nëse po, a keni paraqitur kërkesë për plotësimin e vakancës pranë DPAP? Nëse keni paraqitur kërkesë për plotësim të vakancës në DPAP, cila ka qenë përgjigja e këtij institucioni për plotësimin e vendit të lirë?

Me shkresën nr. 645/1 prot., datë 03.04.2024 ZVAP Fier i ka kthyer përgjigje ankueses ku ka informuar se: *Pozicioni i specialist/jurist në institucionin e ZVAP Fier është vakant që nga data 01.10.2023. ZVAP Fier ka bërë kërkesë për plotësimin e vendit vakant në pozicion specialist/jurist në Sektorin e Shërbimeve të Përgjithshme dhe është në pritje të plotësimit të organikës për këtë pozicion.*

Nga ankuesja ka dhe komunikim elektronik në lidhje me kërkesat për informim për të cilat ka marrë të njëjtat përgjigje sikurse u cituan më sipër. Gjithashtu dhe një kërkesë tjetër për punësim për të cilën i është kthyer përgjigje më shkresën nr.595/3 prot., me datë 26.03.2024 nga DPAP, ku ka mbajtur të njëjtin qëndrim si dhe e ka informuar ankuesen se në bazë të Vendimit nr.129, datë 06.03.2024 "*Për disa ndryshime në Vendimi nr.99, datë 27.02.2018 " Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore "* të Këshillit të Ministrave, DPAP, është emëruar Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP).

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit "*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*". Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, "*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*". Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë bindjet politike dhe gjendjen shëndetësore, si shkaqe të mbrojtura. Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me "gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji" dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*⁵, sanksionon të drejtën për punë në nenin 6. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim bazuar ndër të tjera në gjendjen shëndetësore dhe bindjet politike të personit.

*Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës*⁶ “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit, në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes së barazisë, mundësive ose trajnimit, në punësim dhe profesion. Konventa garanton mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe opinionit politik.

*Karta Sociale Evropiane*⁷ parashikon të drejtën për punë në nenin 1 të saj. Në vijim, në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Evropiane parashikohet shprehimisht: “Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkakut të tillë si racë, ngjyrë, seks, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjine shoqërore, shëndeti, shoqërimi me një minoritet kombëtar, lindje ose statusi tjetër”.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Bazuar në nenin 21/1, të Kodit të Punës, kontrata e punës lidhet me shkrim dhe mund të ndryshohet nëse palët bien dakord për ta bërë atë. Referuar pikës 2, të nenit 21, të Kodit të Punës, kontrata e punës quhet e lidhur kur punëmarrësi pranon kryerjen e punës ose shërbimit, për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar.

Bazuar në këtë rregullim ligjor të Kodit të Punës, që përbën legjisllacionin që rregullon marrëdhëniet e punës për rastin e ankueses, Komisioneri vlerëson se pozicioni i punës për

⁵ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

⁶ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

⁷ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.

ankuesen është ai i specialist/jurist në Sektorin e Shërbimeve të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë.

Arsimi parauniversitar në Republikën e Shqipërisë rregullohet sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar. Referuar nenit 25, të këtij ligji përcaktohet se: *Funksionet kryesore të ministrisë janë: a) përgatitja e akteve ligjore dhe nënligjore të sistemit arsimor; b) zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar; c) vlerësimi i cilësisë së shërbimit arsimor mbi bazën e treguesve; ç) kontrolli i zbatimit të ligjshmërisë dhe i përdorimit të fondeve në institucionet arsimore; d) hartimi dhe zbatimi i politikave të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë dhe akreditimi i programeve trajnuese; dh) sigurimi i mbështetjes profesionale nga institucione të specializuara, vendase ose të huaja, për kërkime dhe eksperimentime në fushën e arsimit; e) bashkëpunimi në fushën e arsimit me ministrinë e linjës, njësitë e qeverisjes vendore dhe me organizma të tjerë qeveritarë ose joqeveritarë, të vendit ose të huaj; ë) publikimi për çdo vit shkollor i raportit të arritjeve të sistemit arsimor parauniversitar.*

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) në Shqipëri është krijuar në bazë të Vendimit i Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 27.02.2019" *Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore* ", të ndryshuar me VKM nr.129/06.03.2024. Në këtë VKM janë përcaktuar detyrat funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Pronës Publike (DPAP). Në detyrat funksionale të saj përfshihen ndër të tjera:

1. Planifikimi i Strukturave Arsimore

- Analiza e nevojave arsimore: DPAP është përgjegjëse për të kryer një analizë të nevojave arsimore në nivel kombëtar dhe rajonal, duke përfshirë numrin e nxënësve, kërkesat për mësuës, dhe kapacitetet e shkollave.
- Hartimi i Planit të Strukturave Arsimore: Bazuar në analizat dhe rekomandimet nga DAR dhe ZA, DPAP harton planin vjetor të strukturave arsimore për institucionet parauniversitare. Ky plan përfshin numrin e mësuesve dhe stafit tjetër arsimor që nevojitet për çdo institucion arsimor, duke marrë parasysh zhvillimet demografike dhe objektivat strategjike të arsimit.
- Miratimi dhe Monitorimi: Plani i strukturave arsimore i paraqitet Ministrisë së Arsimit për miratim. Pasi të miratohet, DPAP monitoron zbatimin e tij nga DAR dhe ZA për të siguruar që të gjitha vendet e punës të planifikuara janë të mbuluara dhe se institucionet arsimore funksionojnë në përputhje me normat e përcaktuara.

2. Procedurat e Konkurrimit për Punësimet

- Shpallja e Vendeve të Lira: DAR dhe ZA janë përgjegjëse për shpalljen e vendeve të lira të punës në institucionet e arsimit parauniversitar, në përputhje me planin e miratuar nga DPAP. Shpalljet përfshijnë pozicionet e disponueshme, kërkesat për kualifikim dhe afatet për aplikim.

- Organizimi i Procedurave të Konkurrimit: DPAP, në bashkëpunim me DAR dhe ZA, organizon dhe mbikëqyr procedurat e konkurrimit për pozicionet e shpallura. Këto procedura përfshijnë vlerësimin e dokumentacionit të aplikantëve, testimet me shkrim dhe intervistat.
- Përzgjedhja dhe Emërimi: Pas përfundimit të procedurave të konkurrimit, DPAP, në bashkëpunim me DAR dhe ZA, përzgjedh kandidatët më të mirë dhe procedon me emërimin e tyre në pozicionet përkatëse. DPAP ka rolin e monitorimit dhe garantimit të transparencës dhe drejtësisë në këtë proces.
- Mbikëqyrja e Zbatimit: DPAP mbikëqyr procesin e zbatimit të procedurave të konkurrimit dhe punësimit për të siguruar që ato kryhen në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi. Në rast shkeljesh ose ankesa, DPAP ka kompetencë të ndërhyjë dhe të rishikojë vendimet përkatëse.

Këto funksione sigurojnë që institucionet e arsimit parauniversitar të kenë struktura të mirëplanifikuara dhe staf të kualifikuar, duke mbështetur kështu një sistem arsimor të qëndrueshëm dhe efikas.

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 27.02.2019, i cili rregullon krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar, përgjegjësia për miratimin e strukturës dhe organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) i përket Ministrit të Arsimit dhe Sportit.

Në përputhje me këtë kuadër ligjor, Ministri i Arsimit ka autoritetin përfundimtar për miratimin e strukturave dhe organikës së ZVAP, duke siguruar që ato të përmbushin standardet dhe nevojat e sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri.

Në bazë të Urdhrit nr.234, datë 19.04.2019 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit është bërë miratimi i strukturës dhe organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar.

Në bazë të Urdhrit nr. 454, datë 13.09.2019 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit është miratuar Rregullorja për rregullat dhe procedurat e konkurrimit dhe lirimit nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj.

Sa më sipër, Komisioneri konstaton që me shkresën nr. 2345 prot., datë 11.10.2023 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar Tiranë, znj. J. S, ka shprehur vullnetin e saj për dhënien e dorëheqjes nga pozicioni i specialist/juristes, duke sqaruar dhe shkaqet e saj në lidhje me kërkesën e saj se: *Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar kanë struktura jo të përshtatshme. Krahas detyrave të pozicionit tim të punës, gjatë punës kam kryer punë të cilat nuk janë pjesë e detyrave funksionale që ligji më ngarkon si dhe kam kryer punë jashtë orarit si dhe nuk respektohen parashikimet e kontratës së punës nga punëdhënësi.*

Në këtë moment sqarojmë se, kompetencat për ndryshimet strukturore të ZVAP-ve, është detyrë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, dhe nga ana e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar Tiranë (*ish DPAP*), është bërë kërkesa si për ndryshimet strukturore por dhe për shpalljen e procedurave të konkurrimit për të gjitha pozicionet e punës në DPAP/DRAP dhe ZVAP-vë. (*Referuar informacionit të dërguar me shkresën nr. 1940/3 prot., datë 15.07.2024*)

Gjithashtu, Agjencia Kombëtare të Arsimit Parauniversitar Tiranë (*ish DPAP*) informon se i ka i dërguar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit kërkesën me propozimet përkatëse, për shpalljen e procedurave të konkurrimit për të gjitha pozicionet e punës në DPAP/DRAP dhe ZVAP-ve. Shpalljet për konkurrim do të bëhen pasi të miratohen ndryshimet strukturore të DPAP/DRAP dhe ZVAP-ve. Me miratimin e planit për shpalljen e procedurave të konkurrimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, DPAP-ja do të bëjë shpalljet ku të gjithë të interesuarit kanë të drejtë të aplikojnë dhe të konkurrojnë për pozicionet e lira të punës që do të shpallen, sipas profilit të diplomës që disponojnë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se në zbatim të detyrimeve ligjore sipas kompetencave që i ngarkon ligji, Agjencia Kombëtare të Arsimit Parauniversitar Tiranë (*ish DPAP*), i ka adresuar problematikat institucionit hierarkik për rregullimin strukturor të tyre dhe për marrjen e masave për plotësimin e vakancave sipas procedurave dhe mënyrës së parashikuar në aktet ligjore në fuqi.

Referuar përcaktimeve ligjore të bëra në pikën 13 të VKM nr.99, datë 27.02.2019 "*Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore*", të ndryshuar, është parashikuar se: *Marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe nëpunësve të DPAP-së, në nivel qendror e rajonal, si dhe në njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Pranimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, mbi bazën e rregullave të miratuara me urdhër të ministrit.*

Sipas përcaktimeve të pikës 4, të Urdhrit nr.454, datë 13.09.2019 "*Për miratimin e rregullores dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirimin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj*" të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, është parashikuar se: *Marrëdhëniet e punës brenda fushës së zbatimit të kësaj rregullore mbështeten në dispozitat e Kodit të Punës. Pranimi dhe lirimi nga detyra e punonjësve bëhet përmes konkurrimit të hapur...*

Në lidhje me pretendimet e ankueses për diskriminim nga ana e DPAP-së për ripunësimin e saj në pozicionin e mëparshëm sqarojmë se nga ana e institucionit i është kthyer përgjigje për të gjitha kërkesat e saj duke e sqaruar se: *Pranimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve në ZVAP, Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit.*

Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore në drejtorinë qendrore të DPAP, përgatit planin vjetor të nevojave për pranime, sipas vendeve vakante në të gjitha nivelet e organizimit të DPAP. Në rastet e krijimit të vendeve të lira gjatë vitit, të cilat janë të pamundura të parashikohen në planin vjetor të nevojave, menjëherë me krijimin e tyre institucioni përkatës bën kërkesë në njësinë përgjegjëse për burimet njerëzore në drejtorinë qendrore të DPAP, pranimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, mbi bazën e rregullave të miratuar me urdhër ministri.

Lidhur me pretendimin e ankuese se njëjtën kohë që ka paraqitur kërkesën për punësim me kontratë provizore, deri sa të kryhen procedurat e konkurrimit, DPAP ka punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier, punonjëse me kontratë provizore deri në përfundim të procedurave të konkurrimit për pozicionin "Jurist", nga informacioni i dërguar pranë Komisionerit rezultoi që pranë ZVAP Fier nuk është emëruar asnjë punonjës në pozicionin e juristit dhe se ky pozicion është vakant.

Në lidhje me emërimin provizor deri në shpalljen për konkurrim të pozicionit specialist/juristit, të znj. A. Rr, nga institucioni është shpjeguar se: *Punësimi i Znj. A. Rr, është bërë vetëm për mbarëvajtjen e punës në këtë institucion dhe është me kontratë provizore deri në momentin e ristrukturimit, i cili mendohet të mbyllet brenda muajit Tetor 2024.*

Ndërkohë në parashtrimet e dhëna Komisionerit në lidhje me qëndrimin e institucionit mbi kërkesat për ripunësim të ankuses, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (ish-DPAP) është shprehur se: *Ripunësimi i Znj. J. S, nuk është kryer nga institucioni ynë, pasi Znj. S, pasi është larguar me dorëheqje nga vendi i saj i punës. Znj S, në momentin që ka qenë e punësuar në pozicionin specialist/jurist në ZVAP Vlorë, është shprehur në dorëheqje që nuk ka qenë dakord me strukturën, si dhe ka pretenduar që ka kryer punë të cilat nuk janë pjesë e detyrave funksionale që ligji e ngarkon si dhe për punë jashtë orarit zyrtar, në kushtet kur nuk kanë ndryshuar as struktura dhe as kushtet e punës për të cilat ka shprehur mosdakordësi, nuk mund të kërkojë të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës.*

Znj. S, është në marrëdhënie pune pranë Zyrës së Shërbimit të Provës Vlorë, prej datës 26.01.2024. Nëpërmjet kërkesës së saj, në të cilën pretendon diskriminimin, sqarojmë se nga ana e institucionit tonë i është dhënë gjithë mundësia për të ecuar në karrierë duke e ngarkuar të ushtrijë dhe funksionin e Drejtor i ZVAP Vlorë deri në plotësimin e vakancës. Kërkesa për diskriminim e bërë nga Znj. S, është një kërkesë në keqbesim nga ana e ish punëmarrësit, e cila me dashje kërkon të përfitojë financiarisht dhe të dëmtojë reputacionin e punëdhënësit.

Në këto kushte Komisioneri vlerëson, se për sa kohë që nuk kanë ndryshuar strukturat dhe kushtet në pozicionin e punës të mbajtur më parë nga znj. S, nga i cili ankuesja me vullnetin e saj të lirë ka dhënë dorëheqje, ka mundësinë të aplikojë për pozicionin e dëshiruar pas ndryshimeve strukturore të institucionit, me shpalljen e tyre për konkurrim, pasi sikurse u shpreh dhe

institucioni, janë në fazën e miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (ristrukturimit, i cili mendohet të mbyllet brenda muajit Tetor 2024).

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se marrëdhënia e mëparshme e punësimit me AKAP me ankuesen ka përfunduar, dhe si pasojë nuk ekziston më një lidhje juridike e punësimit midis ankuses dhe institucionit. Në këto kushte, plotësimi provizor i vendit vakant kërkon një marrëdhënie të re punësimi, për të cilën AKAP nuk ka ndonjë detyrim ligjor për të rekrutuar automatikisht ish-punonjësit.

AKAP ka vepruar në përputhje me kompetencat dhe rregullat për të mbuluar vendin vakant me një person tjetër, në përputhje me nevojat e institucionit dhe në respektim të dispozitave ligjore. Megjithatë, znj. S, ka të drejtë të konkurrojë për këtë pozicion në momentin që procedurat për rekrutimin e qëndrueshëm shpallen publikisht. Për këto arsye, veprimet e AKAP janë të ligjshme dhe nuk bien në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore në fuqi.

Sa më sipër, bazuar në tërësinë e arsyetimit të mësipërm si dhe në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se, ankuesja J. S, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje të paligjshme nga ana e AKAP, për shkaqet e pretenduara nga ankuesja dhe për rrjedhojë nuk provohet se Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (*ish-DPAP*) ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuses J. S, në të drejtën për punësim, për shkak të çdo shkakut tjetër, nga ana e Agjencisë Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (*ish- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar*).
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

